



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Për: Kuvendin e Komunës
Propozues: Kryetari i Komunës
Hartues: Kryesuesi i Komisionit Vlerësues
Tema: Propozim – vendim

Në bazë të nenit 12.2 pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159, nenin 22 paragrafi 1 i Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 41.2 pika “ç” të Statutit të Komunës, si dhe bazuar në rekomandimin e Komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dt. 31 mars 2021, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më _____ 2021, merr këtë:

VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh bizneseve privatenë parcelat e evidentuara në certifikatën e pronësisë P-70202011-00435-1 dhe P-70202011-00435-3, në sipërfaqen e tërësishme prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive biznesore, si vijon:
 - 2.1 Solid Group Sh.p.k.;
 - 2.2 Druri Sh.p.k.;
 - 2.3 B.t.p. Holding Sh.p.k.;
 - 2.4 Timber Home Sh.p.k.;
 - 2.5 Time N.t.p.;
 - 2.6 Unikonzum;
 - 2.7 Mateo Company Sh.p.k.;
 - 2.8 Homestar N.t.p.;

- 2.9 Vazo Sh.p.k.;
- 2.10 Bunsam Metal Sh.p.k.;
- 2.11 Euro Driloni;
- 2.12 Bina Sh.p.k.;
- 2.13 Ra Eximp Sh.p.k.;
- 2.14 Emona Center Sh.p.k.;
- 2.15 Berto Sh.p.k.;
- 2.16 Te Duli D.p.z.;
- 2.17 Trios Group Sh.p.k.;
- 2.18 Bvd Ing. Sh.p.k.;
- 2.19 AH Invest Sh.p.k.;
- 2.20 Ajna Cake Sh.p.k.;
- 2.21 Union Sh.p.k.;
- 2.22 7 Vëllëzërit Sh.p.k.

- 3. Bizneset e cekura si në pikën paraprake, në tri në 3 vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në vit.
- 4. Prona e paluajtshme e komunës iu ipet në shfrytëzim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.
- 5. Obligohet Kryetari i Komunës që të lidhë kontratë me secilin përfaqësues të bizneseve të cilave të cekura në pikën 2 (dy) të këtij vendimi.
- 6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: rekomandimi i komisionit vlerësues dhe dokumentacioni shtesë i paraparë me legjislacionin në fuqi.
- 7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.
- 8. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit

A r s y e t i m

Komuna e Vushtrrisë ka zbatuar të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për dhënien në shfrytëzim të pronave në Parkun Industrial në Lumadh. Finalizimi i punëpve tani është bërë me përgatitjen e rekomandimit të Komisionit vlerësues i cila ka radhitur të gjitha bizneset të cilat i kanë plotësuar kushtet e parapara me konkurs për vendosje në Parkun Industrial.

Duke qenë se bizneset janë të interesuara që sa më parë të krijohen kushtet dhe mundësitë për të t'u vendosur në hapësirat e Zonës Ekonomike – Parkun Industrial, i propozohet kuvendit të Komunës që të miratoj këtë propozim – vendim si në dispozitiv.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna Vushtrri
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri

KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

Me datë: 31.03.2021

Në bazë të Nenit 19, paragrafi 3, të Ligjit për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Nenit 21 të Projekt Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Statutit të Komunës, Komisioni vlerësues propozon këtë:

REKOMANDIM

Në bazë të këtij Rekomandimi Komisioni për Vlerësim të Ofertave për Park të Biznesit në Fshatin Lumadh-Vushtrri për Parcelat P-702020011-00435-1 dhe P-702020011-00435-3 me sipërfaqe totale prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, njofton anëtarët e Kuvedit Komunal të Vushtrrisë se kanë aplikur gjithësejt 43 biznese për vendosje në Parkun e Biznesit, nga të cilët 22 prej tyre kanë plotësuar dokumentacionin në tërësi në bazë të Kushteve dhe Kriterëve të përcaktuara me Vendim të Kuvendit nr. 269/20 të dt. 30.12.2020, të listuar më poshtë:

Solid Group Sh.p.k.; Druri Sh.p.k.; B.t.p. Holding Sh.p.k.; Timber Home Sh.p.k.; Time N.t.p.; Unikonzum; Mateo Company Sh.p.k.; Homestar N.t.p.; Vazo Sh.p.k.; Bunsam Metal Sh.p.k.; Euro Driloni; Bina Sh.p.k.; Ra Eximp Sh.p.k.; Emona Center Sh.p.k.; Berto Sh.p.k.; Te Duli D.p.z.; Trios Group Sh.p.k.; Bvd Ing. Sh.p.k.; AH Invest Sh.p.k.; Ajna Cake Sh.p.k.; Union Sh.p.k.; 7 Vëllëzërit Sh.p.k.

Komisioni vlerësues njofton Kuvendin Komunal të Vushtrrisë se nga aplikuesit e mësipërm në zonën e parë (I) deri në 50 ari janë rekomanduar 13 biznese, në zonën e dytë (II) 50 ari deri 1 ha janë rekomanduar 6 biznese ndërsa në zonën e tretë (III) mbi 1 ha janë rekomanduar 3 biznese.

Vlera Investive e Bizneseve në Parkun Industrial në Lumadh do të jetë 22 milion € dhe me punësim të ri të planifikuar mbi 800 persona.

Veprimtaritë që do të zhvillohen në Parkun Industrial do të jenë veprimtari afariste të cilat nuk cenojnë rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Bizneset të cilat janë rekomanduar nga komisioni janë biznese me veprimtari prodhuese, përpunuese, shërbyese si dhe ato të cilat kanë numër më të madh të punëtorëve.

Krijimi i zonës ekonomike në Lumadh-Vushtrri ka për qëllim nxitjen dhe inkurajimin e investimeve në Vushtrri duke iu ofruar investitorëve infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim të veprimtarive; të ndihmojë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Komunën e Vushtrrisë, veçanërisht në sektorin privat; hapjen e vendeve të reja të punës dhe krijimin e të ardhurave; tërheqjen e teknologjive të përparuara; përqendrimin e bizneseve në Vushtrri; zgjerimin e bashkëpunimit mes bizneseve; krijimin e kushteve për biznese për qasje më të lehtë në lidhje, transport dhe shërbime në mbështetje të biznesit; rritjen e konkurrencës në biznesin vendor etj.

Përparësitë që ofrohen nga Parku i Biznesit në Lumadh fillojnë nga hapësirat e gatshme dhe komode për akomodim të Bizneseve, lokacion i përshtatshëm për transportin e mallrave dhe shërbimeve në tërë territorin e Kosovës si dhe qasja e lehtë nga Magjistralla M2 deri në lokacion, hapësirë për parkim, siguri të plotë, qasje në rrymë, ujë, telefoni dhe internet.

Pjesë përbërëse e rekomandimit është edhe skica e vendosjes sipas veprimtarive dhe hapësirës adekuate për secilin biznes.

Komisioni në mënyrë unanime ka përkrahur dhe votuar vendosjen e këtyre bizneseve gjithësejt 22 biznese në zonën ekonomike në Lumadh dhe i propozon asamblesë Komunalë në Vushtrri që ashtu sic është vendosur nga komisioni i përzier nga Kuvendi dhe Qeveria Komonale ta përkrahin dhe ti japim shtytje zhvillimit, punësimit dhe progresit të Komunës sonë.

Bizneset e aprovuara nga Kuvendi Komunal i Vushtrrisë brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin e kërkuar sipas Vendimit me nr. 269/20 të dt. 30.12.2020.

Kryesuesi i Komisionit

Adnan LAHU





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna Vushtri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtri

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

N J O F T I M

Përmes email-it janë ftuar edhe përfaqësuesit e BIRN-it për të monitoruar procesin e komisionit për vlerësimin e ofertave për Park të Biznesit në fshatin Lumadh-Vushtri e të cilat kanë marrë pjesë në monitorimin e komplet këtij procesi.

Bashkangjitur gjeni edhe email-in zyrtar dërguar përfaqësuesve të BIRN-it.

Berat Sadiku

From: Adnan Lahu
Sent: Thursday, March 4, 2021 4:45 PM
To: Berat Sadiku; isak.hyseni@hotmail.com; agim.bregaj@hotmail.com; ilmiazemi@hotmail.com; ymerharadinaj@hotmail.com; Aferdita Fejzullahu
Cc: Xhafer Sh. Tahiri
Subject: Njoftim për takim

Të nderuar anëtar të Komisionit për vlerësimin e ofertave për zonë Ekonomike, shpresoj që ky email të ju gjeje mirë me shendet dhe punë. Ju ftojme nesër e Premte në ora 8:30 në Drejtorinë e Urbanizmit në takim të Komisionit.

Me respekt,

Adnan Lahu

Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

028 571 214

044 566 407



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna Vushtri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtri

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

Ç E R T I F I K A T A E P R O N Ë S


Bashkangjitur gjeni fletën poseduese dhe kopjen e planit të parcelave për Parkun e Biznesit në fshatin Lumadh-Vushtri.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY



Zyra kadastrale komunale /Opštinska kancelarija: Vushtrri
Zona kadastrale / katastarska zona: Lum Madh
Lloji i njësish kadastrale /Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Nr. i njësish kadastrale /Br.katastarske jedinice:
Numri i lëndës / Broj predmeta:18-

18/694

KOPJE PLANI / KOPIJA PLANA / COPY OF PLAN



Dat 31.03.2021

Gjeodet





Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E EKONOMISË DHE AMBIENTIT / MINISTARSTVO EKONOMIJE I ŽIVOTNE SREDINE / MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA / IZVOD IZ CERTIFIKATA / EXTRACT OF CERTIFICATE

PERSONI / OSOBA / PERSON : Komuna e Vushtrisë

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 18-661/21
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 31.03.2021 - 10:55
Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

Mbiemri/Emri i afarizimit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name	Emri Ime First Name	Emri i babait Ime oca Father's Name	Gjinia Pol Gender	Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No.	Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili ukupljenja Country of citizenship	Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
Komuna e Vushtrisë			/	600535001	KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO			28.12.2020

A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostiti adrese Address Details	Adresa tjetër Druga adresa Other address	Azhuruar Ažurirano Updated
VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI		AHMET KRASNIQI	VUSHTRRI	28.12.2020

B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

Njesia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit	Komuna / Opština / Municipality	Zona kadastrale katastarska zona Cadastral zone	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type	Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind	Katë/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number	Vendi i quajtur Zvano mesto Place name	Sipërfaqja Površina Area	Shtyrëzimi aktual/Kultura- klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202011-00435-1	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI	Lumnadh / Lumnadh / Lumnadh	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shogëtorë Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA E EPERME / GORNJE POLJE / GORNJE POLJE	130176	Tokë Tjetër - Jo Pjellore - / / Ostalo Zemljiste - Neplodno - / / Otherland - Unproductive - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	
P-70202011-00435-3	VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI	Lumnadh / Lumnadh / Lumnadh	PARCELE / PARCELA / parcel	Pronë shogëtorë Društvena Imovina Socially owned Land / R		FUSHA E EPERME / GORNJE POLJE / GORNJE POLJE	60810	Tokë Tjetër - Jo Pjellore - / / Ostalo Zemljiste - Neplodno - / / Otherland - Unproductive - / /	1 / 1	Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo




Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

ORGANIZIMI I PARCELAVE

Bashkangjitur gjeni skicën për organizimin e parcelave të bizneseve në Parkun e Biznesit në fshatin Lumadh-Vushtrri.

ORGANIZMI I PARCELAVE





Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo



Komuna Vushtrri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtrri

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

PROCESVERBALET

Bashkangjitur gjeni procesverbalet e takimeve të mbajtura nga takimet e komisionit për vlerësim të ofertave për Park të Biznesit në fshatin Lumadh-Vushtrri.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



12.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

- JOT ME DATEN 12.03.2021, E PRENTE -ORA: 15:40, ESHTË DUKË U MBAJTUR TAKIMI I RADHËS NEA KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE FSHATIN LUMADH, VUSHTRRI. PREZENT JANE KRYETARI I KOMISIONIT, TË GJITHË ANËTARËT E KOMISIONIT, SI DHE NJË GAZETAR MONITORUES NEA KALLJO.COM.
- KOMISIONI INFORMOI SE PREJ 14 hektor, ^{për shfrytëzim} infrastrukturës, JANE DEDIKUARNE SHFRYTEZIM PER INFRASTRUKTURE NJË PJESE E SAJ, 11.6 hekt.
- GJITHASHTU INFORMOI SE 22 APLIKACIONE I KANE PLOTËSUAR KRITERET I PREJ 43 APLIKACIONEVE GJITHËSEJ.
- KOMISIONI KONSIDEROI SE KANE BËRË NË FUNDË TE PËRGJEGJESHME DHE NË MËNYRË SA ME REALE, PIKA TE CILAT JANE SAKTUAR SI KRITERE KYQE KANE QENË SA ME TE PAQESME, DHE SHPRE-
SOJNË QË DO TË ULIM PAPUNËSIN NE NUMER SA ME TE MADH.

Adnan Lahu, kryetar i Komisionit

Berat Sadiku, anetar

Ilmi Azemi, anetar

Isak Hyseni, anetar

Agim Bregaj, anetar

Ymer Haradinaj, anetar



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



12.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

- Komisioni informoi qe e gjithë procesi është zhvilluar në bazë të ligjit për bizneset, si dhe ligjit për dhënie në shfrytëzim të pronave publike.
- Gjithashtu u sqarua qe shumica e aplikuesve kanë qene kompani serioze dhe kanë plotësuar kriteret e caktuara.
- U diskutuan edhe njëherë kriteret kyqes qe kanë qene të caktuara në bazë të vendimit.
- Në bazë të 22 aplikacioneve qe i kanë plotësuar kriteret numri 1 të punësuarëve qe do të arrihet është 788 punëtor.
- Prej 22 aplikacioneve 12 biznese janë nga Vushtrria, 2 nga Mitrovica, dhe 2 nga Prishtina.
- Anëtari 2 ymer Haradinaj i komisionit, falenderoi për sqarimin nga takimi i kaluar, pasi qe nuk ishte prezent për shkak COVID-19.

Adnan Lahu, kryetar i Komisionit

Berat Sadiku, anetar

Ilmi Azemi, anetar

Isak Hyseni, anetar

Agim Bregaj, anetar

Ymer Haradinaj, anetar



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



12.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

- Z. YMER HARADINAJ THEKESOI SE ESHTË ~~MIRË~~ ^{MIRË} DË TE JENE VIGJILENT, DHE TE KUJDESHEM, SE CILEN NGA KRITERAT NUK E KANE PLOTESUAR APLIKIMET E REFUZUAR, SI DHE TE JENE TE DARTA ARSYETIMET PER APLIKUESIT.
- ISHE I GATSHEM TE SHITTE LISTEN, SI DHE QDO ANETAR I KOMISIONI TE KENE LISTEN E 22 APLIKACIONEVE QE I KANE PLOTESUAR KUSHTET, DHE TE JENE SA ME TE HAPUR, DHE SA MA TRANSPARENT DHE LOGARIDHËNES NE IMPLEMENTIMIN E KETIJ PROJEKTI MADHORE.
- KOMISIONI INFORMOI QE ESHTË EDHE KOMISIONI PER ANKESA, QE ESHTË I GATSHEM TE TRAJTOJ SDO ANKESË E CIA VIE NGA QDO APLIKANT.

Adnan Lahu, kryetar i Komisionit

Berat Sadiku, anetar

Ilmi Azemi, anetar

Isak Hyseni, anetar

Agim Bregaj, anetar

Ymer Haradinaj, anetar



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



12.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

- K. KOMISIONIT INFORMOI QE DOTE LEJOHEN TE GJITHA APLIKACIONET TE CILAT KANE PLOTESUAR KRITERET DHE ATO QE NUK KANE PLOTESUAR.
 - KOMISIONI BHE I PAJTIMIT QE NE PROCESIN E QESJES SE APLIKACIONET JENE PRESENT SE PAKU 8 ANETAR TE KOMISIONIT,
 - PUNET NE TERREN JANE MONITORUAR NGA 2. NEXHAT MEROVCI, QE KA PASUR SI ROL MONITORUES, DHE JO VENDIMHARRËS, DHE KA INFORMUA QE KANE MBETUR YETËM AS
 - KOMISIONI INFORMOI QE LOKACIONI SIPAS ZONAVE KANE QENË:
13 aplikime - 50000, 6 aplikues 50 - 100000, dhe 3 aplikime > 100000.
 - JANE LEXUAR TE GJITHË EMRAT E APLIKUESËVE QE KANE PLOTESUAR KRITERET, SIPAS DATËS SE APLIKIMIT, DHE ËSHTË DEKLARUAR SE AKA KONFLIKT INTERESI, DHE 2. ILMI AZEMI DEKLAROI SE "HATED GROUP". KA KONFLIKT INTERESI. 3. YMER HARADINAJ DEKLAROI SE NUK KA KONFLIKT INTERESI DHE TE GJITHË ANETARËT E DHE TE KOMISIONIT DEKLAROI SE NUK KANE KONFLIKT INTERESI.
 - Adnan Lahu, kryetar i Komisionit
 - Berat Sadiku, anetar
 - Ilmi Azemi, anetar
 - Isak Hyseni, anetar
 - Agim Bregaj, anetar
 - Ymer Haradinaj, anetar
- ËSHTË VOTUAR LISTA E APLIKUESËVE QE KANE PLOTESUAR KRITERET, PËRVEÇ APLIKUESIT "HATED GROUP", KU ANETARI I KOMISIONIT 2. ILMI AZEMI, NUK KA HARRË PJESË NE VOTIMIN E KËSAJ KOMPANIJE, PASI QE KA KONFLIKT INTERESI.

- Kryesuesi i komisionit informoi që lista do i dorëgohet secilit anëtar të komisionit, ku çdo aplikant i është vendosur numri i aplikacionit.
- Gjithashtu informoi që 7 ditë janë për akses që nga data e shpalljes së listës.
- Komisioni informoi që caktimi i lokacionit dhe parcedimit i do të bëhet në kuvend, sipas kërkesave që janë bërë.
- Do të bëhet projekti nga dumi dhe drejtoria e kadastrit.
- I gjithë materiali dhe projekti do të dorëgohen në kuvend.
- Komisioni deklaroi se zona e parkut do të jetë i

- 2. ISAK HYSENI, PËRÇEZOI KOMISIONIN NË EMËR TË SHQËRIS CIVILE PËR PUNËN QË DO BËHET.

- Gjithashtu edhe ZAGIM BREGATI, PËRÇEZOI PËR PUNËN E BËRË NGA KOMISIONI.

NË KAQ U MBYLLË TAKIMI I DITËS SË SOTME.

1. ADRIAN LAHU 
2. BERAT SADIKU 
3. ILMI AZEMI 
4. ISAK HYSENI 
5. AGIM BREGATI 
6. YMER HARADINAJ 



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



05.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

SOT ME DATE 05.03.2021, E HËNË ORA 8:30, KOMISIONI NË PREZENÇE
TE ANËTARVE, DHE NË HUNGESË TË NJË ANTARI PËR SHKAK TË COVID-19.
PREZENT NË TAKIM JANË 2. ADNAN LAHU - KRYETAR I KOMISIONIT, 2. BERAT SADIKU-
ANËTAR, 2. ILMI AZEMI - ANËTAR, 2. ISAK HYSENI - ANËTAR DHE 2. AGIM BREGAJ
ANËTAR, NDERSA HUNGOI 2. YMER HARADINAJ, TË FTUAR KANË QENË EDHE
GAZETARËT MONITORUES NEA KALLXO.COM, POR TË CILËT NUK ISHIN PREZENT.
KOMISIONI KONSTATOI SE JANË GJITHSEJTE 43 APLIKACIONE. ME PAJTIH TË
ANËTARËVE TË KOMISIONIT U VENDOS QË TË FILLOJ PUNA PËR HAPJEN E
APLIKACIONEVE. GJATË PUNËS KOMISIONI BËRI VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT
TË APLIKUESËVE NË BAZË TË VENDIMIT PËR SHPALLEN E KONKURSIT
PUBLIC PËR VENDOSJEN TË BIZNESEVE NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH.
KRITERET TË CILAT ISHIN TË CAPTUARA NË BAZË TË VENDIMIT JANË:
FORMULARI I PLOTËSUAR ME TË DHËNAT E KËRKUARA, SERTIFIKATA E
REGJISTRIMIT TË BIZNESIT, HISTORIATI I KOMPANISË, VEPRIMTARIA QË DO
TË ZHVILLOJË DHE PROJEKTI IDEOR.

Adnan Lahu, kryetar i Komisionit

Berat Sadiku, anetar

Ilmi Azemi, anetar

Isak Hyseni, anetar

Agim Bregaj, anetar

Ymer Haradinaj, anetar



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republik of Kosovo
Komuna e Vushtrisë
Opština Vučitrn - Municipality of Vushtrri



05.03.2021

KOMISIONI PER VLERESIM TE OFERTAVE PER PARK TE BIZNESIT NE
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

NE BAZË TE KËTYRE KRITEREVE KOMISIONI BËRI EDHE
KLASIFIKIMIN E BIZNESEVE DUKE KONSTATUAR SE A I PLOTËSOJNE
KRITERET E KERKUARA ME VENDIM DHE DUKE IDENTIFIKUAR NUMRIN
E PUNETOREVE DHE VLERËN INVESTIVE PËR SECILIN APLIKUES.
PAS KLASIFIKIMIT TË APLIKUESVE TE CILËT KANE PLOTËSUAR
KRITERËT, DHE ATYRE TË CILËT NUK KANE PLOTËSUAR KRITERËT
SIPAS VENDIMIT, KOMISIONI U DËKORDUA QE TË MBYLLE PUNIMET
DHE TË CARTOJE TAKIMIN E RADHES NË AFATË SA MË TË
SHKURTE KOHORË.

Adnan Lahu, kryetar i Komisionit

Berat Sadiku, anetar

Ilmi Azemi, anetar

Isak Hyseni, anetar

Agim Bregaj, anetar

Ymer Haradinaj, anetar



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo




Komuna Vushtri
Opstina Vucitrn – Municipality of Vushtri

**KOMISIONI PËR VLERËSIM TË OFERTAVE PËR PARK TË BIZNESIT NË
FSHATIN LUMADH-VUSHTRRI**

V E N D I M E T E K U V E N D I T

Bashkangjitur gjeni vendimet e Kuvendit për shpalljen e Konkursit Publik si dhe Vendimin Paraprak për Dhenjen në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme të Komunës.



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, në lidhje me nenin 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2014 (MTI) për Procedurën Formën dhe Përbajtjen e Konkursit Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë - themelues i Parkut Industrial në Lumadh, në mbledhje e mbajtur më **26 nëntor 2020**, merr këtë:

VENDIM
PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK
PËR VENDOSJE TË BIZNESEVE NË PARKUN INDUSTRIAL NË LUMADH

Vendndodhja: Fshati Lumadh Komuna e Vushtrrisë, kilometri i 18-të, në rrugën nacionale Prishtinë - Mitrovicë.

Parcelat: P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 08.77.90 ha dhe P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 06.08.10 ha.

Madhësia e parcelave të cilat do të jepen në shfrytëzim: varësisht nga kërkesat e subjekteve afariste, zona e parë (I) deri në 50 ari, zona e dytë (II) prej 50 ari deri në 1 hektarë dhe zona e tretë (III) mbi 1 hektarë.

Veprimtaritë e lejuara në parkun industrial: Në parkun industrial mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk cenon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Përparësitë për vendosje në parkun industrial: Me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë ato biznese të cilat merren me veprimtari prodhuese, përpunimit të produkteve si dhe ato të cilat rrisin numrin e punëtorëve në raport me numrin ekzistues të biznesit.

E drejta e aplikimit: Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të përcaktuara në konkurs, që kanë për qëllim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve biznesore dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim: Me rastin e aplikimit për të u vendosur në park industrial të interesuarit duhet dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i plotësuar me të dhënat e kërkuara
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Historiati i kompanisë (biznesit)
- Veprimtaria që do ta zhvilloj
- Projekti ideor

Bizneset e aprovuara në parim brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin në vijim:

- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore
- Dëshminë nga ATK për numrin aktual të të punësuarve
- Planin e Biznesit
- Garancionin bankar prej 5% të vlerës së parashikuar të investimit me rastin e nënshkrimit të kontratës

Kriteret për vlerësim:

Punësimi 40 pikë;

Vlera investive 30 pikë;

Lloji i veprimtarisë 30 pikë;

- Prodhuese 30 pikë,
- Përpunuese 20 pikë,
- Shërbyese 10 pikë,

Afati i dhënies në shfrytëzim – nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Tërheqja e formularit:

Formulari për aplikim mund të merret në zyrën pritëse të komunës – kati përderes çdo ditë pune nga ora 8;30 deri në ora 15;30, ose në faqen zyrtare të komunës.

Dorëzimi i dokumentacionit:

Formulari i plotësuar së bashku me dokumentacionin tjetër të kërkuar me konkurs duhet dorëzuar në mënyrë fizike në zyrën pritëse të komunës (në pliko të mbyllura të vulosura me vulën e biznesit), i cili i adresohet Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Afati i për aplikim: Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Vërejtje: aplikacionet e dorëzuara pas ditës së mbylljes së konkursit nuk do të merren në shqyrtim përveç atyre që arrijnë përmes postës të cilat mbajnë datën e fundit të caktuar në konkurs deri në ora 16;00.

E drejta në ankesë: Bizneseve të cilave iu refuzohet e drejta për të u vendosur në parkun industrial kanë të drejtë ankesë komisionit të ankesave brenda 8 ditëve të punës.

Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRA	
01 Nr. / Br	239/20
Nr. i fq. / Br. i	- / -
Datë / Datum	26.11.2020
VUSHTRRI - VUČITRA	



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës - Vushtrri

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 14 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 11 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159, nenin 6 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) NR.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 41. Paragrafi 2 shkronja "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **26 nëntor 2020** merr këtë:

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË ME KOMPENSIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë me kompensim e pronës së paluajtshme të komunës në Parkun Industrial në Lumadh pjesë nga parcela kadastrale P-70202011-00435-1, në sipërfaqe prej 8.77.90 ha nga sipërfaqja e përgjithshme prej 13.01.76 ha, si dhe parcela kadastrale P-70202011-00435-3 me sipërfaqe prej 6.08.10 ha, në sipërfaqe totale nga dy parcelat prej 14.86 ha, Zona Kadastrale Lumadh, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

2. Ngastrat kadastrale si në pikën 1 (një) të këtij vendimi, iu jepen në shfrytëzim afatgjatë subjekteve afariste për ushtrim të veprimtarive ekonomike sipas Ligjit për Zonat Ekonomike si vijon:

2.1. Në tri (3) vitet e para nga data e nënshkrimit të kontratës me komunën, nuk do të paguajnë kompensim, ndërsa pas tri (3) viteve do të paguajnë 0.05 € (pesë cent) për m² në muaj.

2.2. Prona komunale iu jepet në shfrytëzim në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) viteve.

3. Kuvendi i Komunës duhet të shpall konkurs publik për vendosje të subjekteve afariste në parkun industrial, bazuar në nenin 11 paragrafi 1 të Ligjit për Zonat Ekonomike Nr. 04/L-159 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 03/2014 për Procedurën Formën dhe Përmbajtjen e Konkursit Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat për të drejtën e pronësisë dhe kopja e planit për pronat që do të jepen në shfrytëzim afatgjatë.

5. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.



Nasuf Aliu

Kryesues i Kuvendit